



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës  
Opština Priština - Municipality of Prishtina



KRYETARI I KRYEQYTETIT

14-024/01-70929/23 më 05 APR 2023

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit nr. 03/L-040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28/15 qershor 2008), Ligjit Nr. 04/L-045 për Partneritet Publiko Privat Neni 19 pika 2.4, Direktivës Nr. 2/2011 për Ekipet për Menaxhimin e Projekteve, si dhe nenit 5.1. të Marrëveshjes për Partneritet Publiko Privat për ndërtimin e tri shkollave të reja dhe ofrimin e shërbimeve të mirëmbajtjes dhe operimit në ato shkolla, dhe të nenit 53-të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Kryeqytetit, merr këtë:

### V E N D I M

1. Z. Bekim Mustafa, i lindur në Bujanoc, me datë 14.04.1978, emërohet përfaqësues i Autoritetit Kontraktues, Komunës së Prishtinës, që të ushtroj detyrat dhe përgjegjësitë në pajtim me nenin 5.1 të Marrëveshjes për Partneritet Publiko Privat për ndërtimin e tri shkollave të reja dhe ofrimin e shërbimeve të mirëmbajtjes dhe operimit në ato shkolla.
2. Për kryerjen e detyrave të cekura si në pikën 1 të këtij Vendimi, i emëruari i raporton Kryetarit të Kryeqytetit.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.


#### U DORËZOHET:

- Të emëruarit;
- Z. Fatos Bajraktari "Bao schools" shpk;
- Në dosje.

KRYETARI I KRYEQYTETIT

Përparim Rama





### Shtojca 8 - DORËZIMI I CERTIFIKATËS PËR POSEDIM TË LIRË

Në lidhje me Marrëveshjen për Partneritet Publiko Privat për Ndërtimin e Tri Shkollave të Reja dhe Ofrimin e Shërbimeve të Mirëmbajtjes dhe Operimit në ato Shkolla, të datës 05 dhjetor 2022, e lidhur ndërmjet ndërmjet


KOMUNËS SË PRISHTINËS si Autoritet Kontraktues dhe

BAU SCHOOLS Sh.P.K. si Partner Privat

Dhënësi i Kontratës vërteton se Partnerit Privat i janë dorëzuar lokacionet në pajtim me Marrëveshjen PPP, neni 7.

Prishtinë, 4 prill 2023

KOMUNA E PRISHTINËS

  
Përparim Rama

Kryetar i Komunës së Prishtinës

